REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/35/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokatja Sh. Sh-G, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares Rr.Ll, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 05.09.2022 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga avokate Sh. Sh-G ndaj gjyqtares Rr.Ll, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Avokatja Sh. Sh-G me datë 03.08.2022 përmes emalit dërguar Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares Rr.Ll, e njëjta ankesë është pranuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 05.08.2022.

Me datë 04.08.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore.

Parashtruesja e ankesës av. Sh. Sh-Gka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares Rr.Ll për shkak të pretendimeve se, në seancën gjyqësore të datës 26.07.2022 lidhur me lëndën C.nr.4367/19, gjyqtarja ka përdorur gjuhë të papranueshme, është treguar e njëanshme dhe ka treguar sjellje jo etike.

Tutje, parashtruesja e ankesës ka theksuar se, në lëndën C.nr.4367/19 e përfaqëson me autorizim paditësin N. S. së bashku me avokatin G.G në çështjen statusore familjare "Padi për zgjidhjen e martesës" kundër te paditurës Xh.S, e parashtruar ne Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 10.10.2019.

Ka shtuar se, me datë 26.07.2022 në ora 10:00 sipas ftesës së gjykatës ka pasur seancë gjyqësore, duke theksuar se, në të njëjtën ditë rreth ora 09:10 min ka shkuar te gjyqtarja Rr.Ll për t'u informuar nëse do të mbahet seanca, pasi përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës e ka njoftuar se i njëjti nuk mund të vij në seancë për shkak të infektimit me Covid 19, tutje sipas parashtrueses gjyqtarja Rrezarta i ka thënë se është njoftuar me parashtresë dhe ka shtuar se "ju jeni bë kallaballak avokat në këtë lëndë", ka theksuar se i tha thënë gjyqtares se "vetëm unë dhe G.G jemi", ndërsa gjyqtarja i ka thënë se "është edhe Q.L".

Tutje, në ankesë parashtruesja ka theksuar se, me datë 26.07.2022 në ora 10:00 kanë shkuar në seancë së bashku me av. G.G, dhe pasi gjyqtarja e hapi seancën avokatët u njoftuan nga gjyqtarja se tani paditësin e përfaqëson av. Q.L ndërsa për avokatët tjerë ka revokim, ka shtuar se, gjyqtarja i ka thënë av. Q.L "ti Q. ma sjell revokimin me parashtresë", ndërsa parashtruesja i ka thënë gjyqtares "unë tani po njoftohem nga Ju se pala paska autorizuar kolegen Q. për ta përfaqësuar, por mua pala ime nuk me ka thënë asgjë, dhe as nuk jam në dijeni qe paska një revokim për mua dhe kolegun nga pala jonë N.S", ka shtuar se av. G.G ka thënë "se krejt rregull kishte me qene sikur veç

të ishim njoftuar sepse unë prej pushimi erdha për seancë" tutje sipas parashtrueses, në atë moment ka ndërhy gjyqtarja duke thënë "asnjë fjalë se të shënoj në vërejtje". Ka shtuar se, bazuar ne Ligjin mbi Gjykatat, Gjyqtari duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm ne punën e tij, e në rastin konkret gjyqtarja kishte sjellje komplet të njëanshme, e cila me sjelljet e saj e favorizoj av. Q ndërsa asaj ia cenonte lirinë e fjalës pa të drejtë.

Më tej në ankesë parashtruesja ka theksuar se, pala që e përfaqëson ishte në kontakt me gjyqtaren dhe me personin L.L për të cilat pala/paditësi ka thënë se janë shoqe te ngushta dhe kanë komunikuar së bashku lidhur me çështjen dhe zgjidhjen e saj te shpejt.

Ka shtuar se, sjelljet e gjyqtares ishin te çuditshme nuk përshkonin fare me sjelljet e një zyrtari të lartë apo një gjyqtari, ishin komplet në kundërshtim me kushtetutën, ligjin mbi gjykatat, kodin e etikës etj, sjelljet dhe gjestet e saj tregonin njëanshmëri dhe trajtim jo të barabartë të palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë, ndikimi i gjyqtares dukej qartë edhe gjatë seancës, dhe me një performancë tepër të dobët, shpesh here me gjuhe te urrejtjes sjellje te pahijshme dhe të vrazhdë.

Në lidhje me pretendimet e parashtrueses të ankesës, gjyqtarja Rr.Ll ka deklaruar se, me datë 30.05.2022 është ngarkuar me lëndën C.nr.4367/2019, ndërsa me datë 10.12.2019 është paraqitur padia për shkurorëzim, nga paditësi N.S, përmes të autorizuarve të tij, avokates Sh. Sh-G dhe avokatit G.G. Padia është paraqitur kundër të paditurës Xh.S, e vajzërisë M., nga fshati V. , KK Fushë Kosovë, e me adresë të banimit N.B. R. Gj. Ka shtuar se, gjyqtarja paraprake përmes rrugëve diplomatike - Ministrisë së Drejtësisë - Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në adresën që i është dhënë nga pala paditëse, i ka dërguar të paditurës padinë për përgjigje në padi dhe nga ministria përkatëse janë kthyer përgjigjet se autoritetet në Gj., nuk kanë mundur që komunikimin ta bëjnë me palën e paditur për shkak se nuk janë përkthyer në mënyrë të rregullt të gjitha parashtresat. Pa përfunduar procedura e nisur përmes rrugëve diplomatike, gjyqtarja paraprake me Aktvendimin C.nr 4367/19 datë 03.03.2021 ka obliguar paditësin për sigurimin e adresës, ndërsa përfaqësuesit e paditësit me parashtresën e datës 10.03.2021 kanë kërkuar që të paditurës t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, edhe pse ka pasur procedurë aktive të komunikimit ndërkombëtar. Më tej në deklaratën e saj gjyqtarja e rastit ka theksuar se, gjyqtarja paraprake me Aktvendimin C.nr.4367/19, datë 01.06.2021, ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurën (është caktuar avokat I.R) dhe ka vazhduar procedurën me këtë përfaqësues të përkohshëm, ku edhe e ka mbyllë seancën e shqyrtimit kryesor me datë 06.09.2021. Më pas gjyqtarja paraprake, me Aktvendimin e datës 06.09.2021, ka abroguar aktvendimin e shqyrtimit kryesorë datë 06.09.2021mbi administrimin e provave, e ka rihapur shqyrtimin, dhe ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datën 05.07.2022, që nënkupton se lëndën në fjalë e ka pranuar me seancë të rihapur dhe te caktuar.

Më tej në deklaratën e saj gjyqtarja e rastit ka theksuar se, me datë 05.07.2022, në orën e paraparë, në zyrën e saj është paraqitur paditësi personalisht, sepse ka qenë i ftuar për këtë seancë nga gjyqtarja paraprake. Ka shtuar se, e ka njoftuar palën paditëse se seanca nuk mbahet dhe se këtë rast e ka pranuar nga gjyqtarja paraprake dhe lënda duhet të shqyrtohet nga fillimi, ndërsa për seancën e radhës do të njoftoheni sapo te plotësohen kushte për mbajtjen e saj. Ka theksuar se, ky ka qenë komunikimi i vetëm me palën paditëse, për çka ajo ka hartuar edhe një Shënim Zyrtar.

Ka shtuar se, pasi ka shqyrtuar rastin dhe ka vërejtur se ekzistojnë shumë paqartësi në lidhje me procedurën që është ndjekur nga gjyqtarja paraprake, pasi për palën e paditur janë ndjekur dy rrugë të komunikimit, ajo përmes komunikimit ndërkombëtar dhe i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm, andaj për t'i sqaruar këto gjëra ka caktuar seancë gjyqësore me datën 26.07.2022 ku me ftesa të rregullta janë ftuar Sh. Sh-G dhe G.G, të dy avokatë të paditësit, ndërsa në këtë seancë është paraqitur edhe Avokatja Q.L ku më parashtresën e datës 13.07.2022 ka njoftuar gjykatën se

është e autorizuar për përfaqësim të paditësit. Ka shtuar se, kjo seancë nuk është mbajtur për shkak se përfaqësuesi i përkohshëm i të padituës, avokati I.R, përmes zyrës se informimit ka njoftuar gjykatën se i njëjti është ne izolim shkaku i Covid-it dhe nuk mund të jetë prezent në seancë.

Tutje në deklaratën e saj gjyqtarja ka theksuar se, në këtë seancë avokatja Q.L ka prezantuar një parashtresë ku ka theksuar se paditësi ka revokuar autorizimet për avokate Sh. Sh-G dhe avokat G.G, dhe pasi që është njoftuar me këtë fakt, avokatja Sh., është tensionuar nuk ka pranuar, dhe është vërejtur se mes avokatëve të paditësit ka pasur mosmarrëveshje dhe tensione ne lidhje me atë se kush përfaqëson palën paditëse, ndërsa ajo si gjyqtare është dashur ta mbaj qetësinë dhe rendin ne seancën gjyqësore e cila nuk ka mundur të mbahet nga arsyet e theksuara. Ka shtuar se, nuk qëndron pretendimi i parashtrueses së ankesës se ajo si gjyqtare ka komunikuar me avokaten Q.L, pasi në kohën kur palët kanë qenë duke nënshkruar procesverbalin - pra në prezencë të tyre ka kërkuar nga avokatja Q që parashtresën e prezantuar në seancë për revokim të autorizimit ndaj avokatëve Sh. Sh-G dhe avokat G.G, gjykatës t'ia përcjell përmes shkrimores, ndërsa asnjë komunikim tjetër nuk ka pasur.

Më tej në deklaratën e saj, gjyqtarja e rastit ka theksuar se, komunikimi i paraqitur nga avokatja (SMS) në ankesë mund të jetë komunikim që është bërë nga pala apo avokatët, por nuk është komunikim i saj dhe në asnjë rrethanë nuk mund të më atribuohet gjyqtares ky lloj komunikimi. Ka shtuar se, nuk qëndron pretendimi i parashtrueses, se ajo si gjyqtare ka mësuar palën paditëse se në këtë çështje të veprohet përmes përfaqësuesit të përkohshëm, sepse avokatët në fjalë me parashtresën e datës 10.03.2021 kanë kërkuar nga gjykata që të padituës t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm ngase të padituës nuk i dihet adresa, pra gjykata vetëm ka vepruar në përputhje me kërkesën e të autorizuarve të paditësve. Për më tepër, gjyqtarja e rastit ka theksuar se, është fakt që ka raporte shoqërore me L.L, por e njëjta nuk është as palë e as e autorizuar e palës, e autorizuar e palës paditëse rezultoi të jetë avokatja Q.L, e cila tek në seancën e datës 26.07.2022 ka paraqitur autorizimin për përfaqësim. Ka shtuar se, nuk ka asnjë bazë për të vënë në dyshim objektivitetin e saj si gjyqtare lidhur me rastin në fjalë, për të cilin parashtruesja nuk ka paraqitur asnjë argument, ndërsa problemet në komunikim mes palës dhe të autorizuarve të tyre, nuk do të duhej të përdoren pastaj si mjet për të komplikuar procedurat gjyqësore.

Gjyqtarja, gjithashtu ka deklaruar se, fakti se ka raporte shoqërore me L.L (familjare e avokates) ndërsa avokatja Q.L është e angazhuar për përfaqësim nga ana e paditësit N.S, në rastin konkret, nuk mund ta vë në dyshim paanësinë e saj si gjyqtare, sepse me avokaten në fjalë nuk ka kurrfarë afërsie dhe shoqëri qoftë ajo edhe kolegjiale, dhe në seancën e datës 26.07.2022, i ka trajtuar të gjitha palët prezent në mënyrë të barabartë, dhe procesverbali nga palët e pranishme është nënshkruar pa vërejtje. Tutje, në deklaratën e saj, gjyqtarja ka theksuar, fakti se nuk janë njoftuar palët prezente se ka shoqëri me personin L.L, është se seanca e datës 26.07.2022 nuk është mbajtur. Ka shtuar se, në rastin e mos plotësimit të kushteve për mbajtjen e seancës, ka qenë e pamundur te vihen në dijeni palët për një fakt te tillë se në seance ka munguar përfaqësuesi i palës së paditur Xh. S. ndërsa kanë qenë prezent vetëm 3 avokatet e paditësit N. S, ndërsa një njoftimi tillë duhet të bëhet në prezencën e dy palëve ndërgjyqëse në procedure – në prezencën e paditësit dhe të padituri - në mënyrë për t'u dhënë mundësia palëve të deklarohen nëse kanë kundërshtim ndaj gjyqtares në lidhje me vazhdimin e mëtejmë të çështjes. Në fund të deklaratës së saj gjyqtarja ka theksuar se, një njoftim i tillë do të bëhet sapo të plotësohen kushtet për mbajtjen e seancës.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtares dhe pretendimeve të parashtrueses të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares Rr. Ll.

Rrjedhimisht, Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka bazë të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit Rr. Ll lidhur me mbajtjen e seancës së datës 26.07.2022.

Nga pretendimet e palës ankuese Autoriteti kompetent i kësaj Gjykate vlerëson se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: gjuhë të papranueshme të gjyqtares, njëanshmëri dhe sjellje të papërshtatshme.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për gjuhën e papranueshme, njëanshmëri dhe sjelljet e papranueshme të cilat janë objekt i kësaj ankese disiplinore. Në këtë drejtim, parashtruesja e ankesës nuk ka pasur argumente bindëse se gjuha e përdorur, respektivisht sjelljet e gjyqtares së çështjes bien ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor. Për me tepër, Autoriteti i kësaj gjykate vlerëson se, provat e prezantuara nga parashtruesja (SMS) nuk janë komunikim në mes të gjyqtares dhe palëve, por janë komunikim ndërmjet palës/paditësit dhe avokateve të paditësit, dhe një gjë e tillë nuk mund t'i atribuohet gjyqtares së rastit. Ndërsa sa i përket pretendimeve se gjyqtarja e rastit ka raporte shoqërore me avokaten Q.L, një gjë e tillë nuk është provuar në mënyrë bindëse, por edhe sikur të kishte raporte shoqërore, një fakt i tillë do të duhej të prezantohej në seancë kur plotësohen kushtet për mbajtjen e seancës, për më tepër kur nuk ka kushte për mbajtjen e seancës - në mungesë të palëve - gjykata është e kufizuar vetëm me konstatimin e mungesës së kushteve për mbajtjen e seancës dhe jo edhe diskutim/deklarim tjetër përmbajtjesor. Për më tepër, gjyqtarja e rastit e ka pranuar në deklaratën e saj se ka raporte shoqërore me personin L.L, familjare e avokates Q.L, por L.L nuk është as e autorizuar e palës e as palë në procedurë në lëndën C.nr.4367/19, rrjedhimisht në mungesë të dy palëve paditësit dhe të padituresrespektivisht të autorizuarve të tyre, nuk është mundur të bëhet të ditur palëve prezente fakti se, gjyqtarja e rastit ka raporte shoqërore me familjaren e avokates Q.L, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në lidhje me pretendimin ankimor se, në seancën e datës 26.07.2022 gjyqtarja është treguar e njëanshme gjykata nuk ka mundur te vërtetoj për faktin se procesverbali i kësaj seance është nënshkruar pa vërejtje nga palët, ndërsa pretendimet për gjuhë të papranueshme nuk janë evidentuar në procesverbal dhe në këtë procedurë nuk kanë arritur të provohen në mënyrë asnjanëse dhe të pavarur.

Sa i përket pretendimit ankimor se gjyqtarja e rastit ka pasur komunikim me palën paditëse, një që e tillë qëndron për çka gjyqtarja e rastit menjëherë ka përpiluar shënim zyrtar i cili gjendet në shkresa të lendes, nga i cili rezulton se, me datë 05.07.2022, në orën e paraparë për seancë, në zyrën e gjyqtares është paraqitur paditësi personalisht, i cili ka qenë i ftuar për seancë nga gjyqtarja paraprake, ku gjyqtarja e ka njoftuar palën paditëse se seanca nuk mbahet sepse këtë rast e ka pranuar nga gjyqtarja paraprake dhe lënda duhet të shqyrtohet nga fillimi, ndërsa nuk ka provë se ka pasur komunikim tjetër në mes të paditësit dhe gjyqtares.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoi se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/35/22, me datë 05.09.2022

Albina Shabani Rama

_____

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë